

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-1372/3
Data / Datum / Date: 05 / 06 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex: -6-
PRISHTINE/A (2024)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 03 /2026
Datë: 04 . 06 .2026

Në mbështetje të neneve 9, 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 10 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) dhe nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 22 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenin 25 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeminstrija dhe Ministrija në detyrë e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për dorëheqje e z. Ylli Ahmeti, i emëruar noter në territorin e Komunës së Mitrovicës, dhe i pushon ushtrimi i detyrës së noterit.
2. Shfuqizohet Vendimi nr. 229/2024, i datës 15.07.2024, për emërimin e z. Ylli Ahmeti në detyrën e noterit dhe Vendimi nr. 114/2025 i datës 26.03.2025 për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr. 229/2024 të datës 15.07.2024, z. Ylli Ahmeti është emëruar në detyrën e noterit për territorin e Komunës së Mitrovicës, ndërsa me Vendimin nr. 114/2025 të datës 26.03.2025, z. Ahmeti është caktuar të fillojë të ushtrojë detyrën e noterit me datën 07.04.2025.

Me datë 28.05.2026, përmes shkresës zyrtare drejtuar Ministres së Drejtësisë, të protokolluar me nr. 01-1372, z. Ahmeti ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së noterit, duke përmendur rrethanat financiare si shkak për dorëheqje.

Andaj, meqë dorëheqja e tij është paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Z. Ylli Ahmeti;
- Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Odës së Noterëve të Kosovës;
- Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

Besiana Havolli

From: Elbasan Dervishaj
Sent: Monday, June 1, 2026 9:52 AM
To: Dardan Tolaj
Cc: Ridvan Hoti; Besiana Havolli
Subject: FW: Draft vendim (Ylli Ahmeti) - lek.
Attachments: Propozim-Vendim për lirimin nga detyra e noterit per shkak te doreheqjes- lek..docx

I nderuar z. Tolaj,

Uroj të jeni mirë,

Bashkëngjitur gjeni draft vendimin për Ylli Ahmeti,

Me respekt!

Elbasan Dervishaj

Drejtore i Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika

Email. elbasandervishaj@rks-gov.net

Tel. 03820067092

From: Syzanë Paçarizi <Syzane.Pacarizi@rks-gov.net>
Sent: Monday, June 1, 2026 9:11 AM
To: Mimoza Blakaj <Mimoza.Blakaj@rks-gov.net>
Cc: Elbasan Dervishaj <Elbasan.Dervishaj@rks-gov.net>; Fadilete Hoxha <Fadilete.Hoxha@rks-gov.net>; Ilir Bunjaku <ilir.bunjaku@rks-gov.net>; Nevahir Hazeri <Nevahir.Hazeri@rks-gov.net>
Subject: RE: Draft vendim (Ylli Ahmeti) - lek.

Përsëndetje e nderuar,

Bashkëngjitur mund të gjeni materialin me lekturë sipas kërkesës.

Me respekt,

Syzanë Paçarizi

Zyrtare e Lartë për Lekturim

Ministria e Drejtësisë, Ndërtesa e Qeverisë, nr.II

Kati VIII, Zyra 803

Mob. 044/408-246

From: Mimoza Blakaj <Mimoza.Blakaj@rks-gov.net>
Sent: Friday, May 29, 2026 2:33 PM
To: Syzanë Paçarizi <Syzane.Pacarizi@rks-gov.net>
Cc: Elbasan Dervishaj <Elbasan.Dervishaj@rks-gov.net>; Fadilete Hoxha <Fadilete.Hoxha@rks-gov.net>; Ilir Bunjaku <ilir.bunjaku@rks-gov.net>
Subject: FW: Draft vendim

E nderuar znj. Paçarizi,

Ju lutem, a mund të lekturoni dokumentin e bashkangjitur.

Faleminderit në mirëkuptim dhe bashkëpunim!

Punë të mbarë!

*Me respekt,
Mimoza Blakaj*

*Zyrtare e Lartë në Divizionin për Profesione të
Lira/Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë,
Profesione të Lira dhe Statistika
Ministria e Drejtësisë
Tel:038/200-67094
e-mail: mimoza.blakaj@rks-gov.net*

From: Rinor Gjergji <rinor.gjergji@rks-gov.net>

Sent: Friday, May 29, 2026 2:30 PM

To: Mimoza Blakaj <Mimoza.Blakaj@rks-gov.net>; Lulzim Beqiri <Lulzim.Beqiri@rks-gov.net>

Cc: Ridvan Hoti <Ridvan.Hoti@rks-gov.net>; Elbasan Dervishaj <Elbasan.Dervishaj@rks-gov.net>; Fadilete Hoxha <Fadilete.Hoxha@rks-gov.net>

Subject: RE: Draft vendim

Përshëndetje, e nderuar,

Sipas kërkesës, ju lutem gjeni ndryshimet e reflektuara në draftin tuaj (bashkëngjitur në këtë e-mail).

Punë të mbarë!

Me respekt,

Rinor Gjergji

U.D. Udhëheqës i Divizionit për Legjislacionin e Fushës Penale dhe për Organizimin e Sistemit të Drejtësisë /
Acting Head of Division for Criminal Legislation and Organization of the Justice System
Departamenti Ligjor / Legal Department
Ministria e Drejtësisë / Ministry of Justice
Tel: (+383) 45 384 897

From: Rinor Gjergji

Sent: Friday, May 29, 2026 11:01 AM

To: Mimoza Blakaj <Mimoza.Blakaj@rks-gov.net>; Lulzim Beqiri <Lulzim.Beqiri@rks-gov.net>

Cc: Ridvan Hoti <Ridvan.Hoti@rks-gov.net>; Elbasan Dervishaj <Elbasan.Dervishaj@rks-gov.net>; Fadilete Hoxha <Fadilete.Hoxha@rks-gov.net>

Subject: RE: Draft vendim

Përshëndetje, e nderuar,

Uroj të jeni mirë!

E shikova projekt-vendimin dhe i kam disa sugjerime:

1) Të ndryshohet preambula, e cila aktualisht është kështu: “në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) – Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në bazë të kërkesës nr.01-1372/2, të datës 28/05/2026 Zëvendëskryeministrja dhe Ministria e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë”.

1.1. Rregullorja të cilës i referoheni nuk është më në fuqi;

1.2. Në Preambulë gjithmonë duhet të vendoset **baza ligjore** që e autorizon një autoritet për të nxjerrë një akt. Kërkesa nr.01-1372 nuk është bazë ligjore; ajo është thjesht një bazë faktike, që ndikon në nxjerrjen e këtij Vendimi dhe, si e tillë, ajo duhet të reflektohet në arsyetim sepse shërben si arsye për nxjerrjen e Vendimit. Rrjedhimisht, ajo s’ mund të përmendet në Preambulë.

1.3. Te baza ligjore, jeni referuar në nenin 11 të Ligjit për Qeverinë, që flet për kompetencën e ministrave. Megjithatë, marrë parasysh faktin se Ministria jonë është njëkohësisht edhe Zëvendëskryeministre, atëherë është mirë t’i referoheni edhe nenit 10 (veçmas paragrafi 1.4.), që flet për kompetencat e zëvendëskryeministrave.

2) Të shënohet “Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit” te pika 4.

3) Meqë noteri ka ushtruar veprimtarinë në Mitrovicë, nuk e kam të qartë pse e keni shkruar në fund “Vendimi i dërgohet Gjykatës në Podujevë”. Mbase ka qenë lëshim dhe keni menduar Gjykatës në Mitrovicë.

Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim shtesë, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni!

Me respekt,

Rinor Gjergji

U.D. Udhëheqës i Divizionit për Legjislacionin e Fushës Penale dhe për Organizimin e Sistemit të Drejtësisë /
Acting Head of Division for Criminal Legislation and Organization of the Justice System

Departamenti Ligjor / Legal Department
Ministria e Drejtësisë / Ministry of Justice
Tel: (+383) 45 384 897

From: Mimoza Blakaj <Mimoza.Blakaj@rks-gov.net>

Sent: Friday, May 29, 2026 10:17 AM

To: Lulzim Beqiri <Lulzim.Beqiri@rks-gov.net>

Cc: Ridvan Hoti <Ridvan.Hoti@rks-gov.net>; Elbasan Dervishaj <Elbasan.Dervishaj@rks-gov.net>; Fadilete Hoxha <Fadilete.Hoxha@rks-gov.net>; Rinor Gjergji <rinor.gjergji@rks-gov.net>

Subject: Draft vendim

I nderuar z.Beqiri,

Ju lutem gjeni bashkangjitur draft vendimin për dorëheqje për z. Ylli Ahmeti, noter i emëruar ne Komunën e Mitrovicës.

Andaj, ju lutem, nëse keni mundësi ta rishikoni sot, do të na ndihmonit shumë në përfundimin me kohë të procedurave dhe evitimin e ndonjë vonese të mundshme.

Ju falënderoj paraprakisht,

*Me respekt,
Mimoza Blakaj*

*Zyrtare e Lartë në Divizionin për Profesione të
Lira/Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë,
Profesione të Lira dhe Statistika
Ministria e Drejtësisë
Tel:038/200-67094
e-mail: mimoza.blakaj@rks-gov.net*